

**VENDIM**  
**Nr.23, datë 16.2.2011**

**PËR MIRATIMIN E MEMORANDUMIT TË BASHKËPUNIMIT, NDËRMJET KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE DHE KËSHILLIT TË MINISTRAVE, PËR ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE, 2011**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në mbledhjen e datës 16.2.2011, me pjesëmarrjen e:

|               |          |
|---------------|----------|
| Arben Ristani | kryetar  |
| Hysen Osmanaj | anëtar   |
| Klement Zguri | anëtar   |
| Vera Shtjefni | anëtare, |

mbështetur në nenin 21 pika 1 të ligjit nr.10 019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”,

**VENDOSI:**

1. Miratimin e memorandumit të bashkëpunimit, ndërmjet Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe Këshillit të Ministrave, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të vitit 2011, bashkëlidhur këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI**  
**Arben Ristani**

**MEMORANDUM BASHKËPUNIMI**  
**PËR ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE QË DO TË ZHVILLOHEN**  
**NË DATËN 8.5.2011**

*Mbështetur* në dekretin nr.6668, datë 6.9.2010 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, më 8.5.2011 do të zhvillohen zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore;

*mbështetur* në ligjin nr.10 019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ngarkohet me detyrën për të përgatitur, mbikëqyrur, drejtuar dhe verifikuar të gjitha aspektet që kanë të bëjnë me zgjedhjet;

*mbështetur* në faktin që Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, në zbatim të Kushtetutës, legjislacionit shqiptar, si dhe të marrëveshjeve ndërkombëtare, ku shteti shqiptar është palë, është seriozisht i angazhuar për mbajtjen e zgjedhjeve të lira, demokratike, të ndershme dhe në përputhje me standardet ndërkombëtare;

*duke marrë parasysh* rëndësinë e madhe që kanë zgjedhjet për të ardhmen e vendit dhe në kuadër të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit me Bashkimin Europian;

*të bindur* se për realizimin e këtyre standardeve kërkohet bashkëpunim serioz dhe i vazhdueshëm midis Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe strukturave shtetërore në varësi të Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë;

*me qëllim* përmbushjen në shkallë institucionale të këtij bashkëpunimi,

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë (më poshtë referuar si “Këshilli i Ministrave”) dhe Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (më poshtë referuar si KQZ-ja), nënshkruajnë këtë memorandum bashkëpunimi.

Palët në këtë memorandum veprojnë në përputhje me statusin e tyre institucional, të përcaktuar në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, Kodin Zgjedhor dhe legjislacionin në fuqi, dhe bien dakord si më poshtë:

#### I. Detyrimet e Këshillit të Ministrave

Këshilli i Ministrave mbështetet dhe i garanton KQZ-së:

1. Sigurimin e mjediseve të nevojshme për KZAZ-të dhe VNV-të, duke përfshirë kushte të përshtatshme për aplikimin e teknologjisë mbështetëse për numërimin e votave, si dhe për sigurimin e linjave të komunikimit.

2. Sigurimin e ambienteve për zyrat rajonale zgjedhore të KQZ-së.

3. Angazhimin e strukturave në varësi të Këshillit të Ministrave për transportin e bazës materiale zgjedhore, nga KQZ-ja në KZAZ-të, në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë dhe anasjellas.

4. Ministria e Brendshme ngarkohet të mbikëqyrë përmbushjen e angazhimeve të parashikuara në Kodin Zgjedhor dhe në këtë memorandum nga të gjitha institucionet në varësi të Këshillit të Ministrave dhe nga organet e qeverisjes vendore.

5. Prefektët, mbështetur në Kodin Zgjedhor dhe në aktet e KQZ-së, bashkërendojnë realizimin e detyrave të parashikuara në të gjitha aktet ligjore dhe nënligjore, si dhe në këtë memorandum në të gjithë territorin e juridiksionit administrativ përkatës.

#### II. Detyrimet e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

KQZ-ja merr përsipër dhe garanton:

1. T'i sigurojë Këshillit të Ministrave dhe të gjitha institucioneve në varësi të tij, në kohën e nevojshme, informacionin e duhur për të lejuar përmbushjen e angazhimeve, në funksion të administrimit të procesit zgjedhor, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

#### III. Hyrja në fuqi

Ky memorandum bashkëpunimi hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PËR KËSHILLIN E MINISTRAVE  
MINISTRI I BRENDSHËM  
**Lulzim Basha**

PËR KOMISIONIN QENDROR TË ZGJEDHJEVE  
KRYETARI  
**Arben Ristani**